

Ekmeleddin İHSANOĞLU

MIQËSIA E TË JATIT ME MEHMET AKIF ERSOJIN

O Ihsan efendi! Po mos të ishe ti, çfarë do të bëja në mërgim? (Mehmet Akifi)

Erdhi një ditë që duhej guxim për ta dashur atë. (Midhat Xhemal)

Ihsan efendiu ishte një njeri nuk lëkundej përballë stuhive, ashtu siç ishte vetë Mehmet Akifi. (Eshref Edip)

Sipas transmetimit të Ali Ulvi beut, Ihsan efendiu kështu e përshkruante shkuarjen në Egjipt me Mehmet Akifin:

Në anijen që merrte rrugë nga Stambolli për në Egjipt, e takova zotëri Mehmet Akifin. Që të dy ishim mërgimtarë të ndarë nga vendlindja dhe miqtë. Ky takim i yni ishte hapi i parë drejt një miqësie dhe besnikërie të thellë. Akifi u vendos në Hilvan, që konsiderohej një qytet për qëndrim veror; ndërsa unë mbeta në Kajro, për të vijuar studimet në Ez'her. Çdo javë vizitonim njëri-tjetrin dhe nxirrnim mall. Shumë i kënaqur jam që kemi miqësi me Akifin; ngase ishte një njeri shembull për drejtësi, trimëri dhe moral. E kaloi një jetë me vuajtje; edhe sprovat i kishte po aq të rënda¹.

Miqësia e Ihsan efendiut me Mehmet Akifin, dashuria dhe respekti i tij për Akifin, është shndërruar në një shembull mirënjohjeje. Ky respekt i ndërsjellë, është parapëlqyer edhe nga bashkëmoshatarët e tij, si

¹ Sare Kurucu, *Bir Ömürden Sayfalar - Ali Ulvi Kurucu'dan Hatıralar*, Marifet Yayınları, 2010 f. 179.

dhe është çmuar nga gjeneratat pasardhëse. Falë kësaj miqësie, Mehmet Akifi, ka mbledhur fuqinë për t'u ndarë nga Kajroja dhe për të marrë rrugë për në Stamboll, në një gjendje të keqe shëndetësore, në mënyrë që frymën e fundit ta marrë në vendlindje; por duke ia besuar këtij miku të ri, besnik dhe me karakter të fortë, përkthimin e tij të Kuranit. Por kjo miqësi e pashembullt, nuk mund të reduktohet vetëm në çështjen besimit për t'ia lënë përkthimin Kuranit. Duhet pasur parasysh që Akifi, poeti i madh i kombit turk, autori i Epopesë së dëshmorëve të Çanakalasë dhe të Marshit të pavarësisë, njëri prej figurave simbolike të Luftës së çlirimit kombëtar, bashkë me Ihsan efendiun, që atë kohë ishte një studiues i ri nga Jozgati, bashkërisht ndienin mallin për vendlindje në mërgimin e përbashkët; mërgim ky të cilin e kishin zgjedhur me vullnetin e lirë të tyre. Duhet pasur parasysh edhe pikëllimet e përbashkëta në këtë mërgim, si dhe gëzimet ku ata takoheshin për të hequr mallin. Kjo miqësi ndërmjet tyre, është e veçantë, e pasembullt dhe shpirtërore; poashtu, kërkon të mendohet thellë për të dhe të respektohet. Kjo miqësi është zhvilluar në ditë të vështira; kohë të cilat Mithat Xhemali i cilëson si “kohë tmerri”, duke thënë se: “Erdhi një ditë që duhej guxim për ta dashur atë. Edhe miqtë, nganjëherë e donin fshehurazi.”

Eshref Edib beu, në librin e tij kushtuar Mehmet Akifit, thotë: “Kur ustai udhëtoi për në Egjipt, ishte së bashku me Ihsan efendiun në të njëjtën anije”. Ai këtë datë e ka shënuar të jetë 1341 hixhri. Kjo datë në shkrimet e mëvonshme është paraqitur të jetë 1925. Por kjo nuk është e saktë. Sepse udhëtimi i babait tim për në Egjipt, ka ndodhë më 1924. Ndërsa vizita paraardhëse në Egjipt e Mehmet Akifit ka ngjarë më 1923. Më 1924 prapë ka shkuar për një vizitë të shkurtër. Kurse më 1925 ka shkuar për t'u vendosur në Egjipt, ku ka qëndruar deri më 1936. Viti kur babai im ka shkuar në Egjipt dihet saktë; prandaj udhëtimi në të cilin kanë qenë se bashku me Mehmet Akifin, ka ngjarë saktësisht më 1924.

Eshref Edip beu, i cili i njihte që të dytë, në një shkrim thoshte:

Ihsan efendi ishte një njeri i vendosur, sa që nuk lëkundej para asnjë lloj stuhie. Përkthimin e Kuranit vetëm atij, Ihsan hoxhës, nga Jozgati², kishte besim t'ia linte për ta ruajtur. Ky njeri, për nga natyra dhe karakteri ishte më i besueshmi për Mehmet Akifin. Me të vërtetë Ihsan hoxha është i tillë. Pos Allahut, asnjë fuqi tjetër nuk mund ta kthejë atë nga bindja dhe besimi i tij.³

Akif beu, prej Hilvanit, në distancë prej 30 kilometrave nga Kajroja, deri në qendër të Kajros, dhe nga aty deri në qendrën studentore “Ebu-Dheheb” udhëtonte me tren lokal, për një orë e gjysmë deri në dy orë. Ashtu që vizitat e Akifit te babai im, ose ato të babait te Akif beu, realizoheshin duke e kaluar këtë rrugëtim. Krahës këtyre vizitave që u bënë ditëve të premte dhe ditëve të bajramit, kishte raste kur Akif beu befasi e vizitonte Ihsan efendiun në zyrën e tij në medrese. Namazin e xhumasë e preferonin ta falnin në xhaminë “Mustafa Fazëll Pasha”, në të cilën Kurani këndohej me mekam nga hafëz Muhammed Rifati, recituesi më i famshëm i Egjiptit, e të cilin e admironin që të dy.

Ndërsa kur takoheshin në shtëpinë e Akif beut, në gramafonin e huazuar nga konaku i Abbas Halim pashës, i luanin pllakat me incizime mevludit, ku këndonte hafëz Kemali. Këto pllaka Akifi i kishte sjellë nga Stambolli.

Eshref Edibi ku rrëfen për vizitat e Akif beut në dhomën e Ihsan efendiut në qendrën e studentëve, i transmeton fjalët në vijim të Ihsan efendiut:

“Ditët kur ustai vinte në medrese, për neve u shndërronin në festë. Në tokat e mërgimit ai ishte si baba dhe mësues për neve. Kur e shihnim atë, ndiheshim sikur ta shohim vendlindjen. Ai ishte njeri i madh. Ishte një virtyt i gjallë.

Poeti i madh i kombit reflektonte butësi të madhe. Ishte kënaqësi për neve të jemi bashkëvendës dhe bashkëkombës me të. Na gufonte

² Një qytet në Turqi [sqarim i përkthyesit].

³ Düccane Cündioğlu, *Bir Kur'an Şairi-Mehmed Akif ve Kur'an Meali*, Kapı yayınları, 2017, f. 536.

zemra për këtë fakt. Kohët që i kalonim me të, ishin kohët më të çmu-eshme të jetës sonë. Kurrë nuk do t'i harrojmë këto. Na recitonte vargje poetike, na thoshte fjalë të mira, na tregonte barsoleta të këndshme dhe tregime të bukura.⁴

Çaji i përzier nga lloje të ndryshme që përgatitej nga Ihsan efendiu dhe byreku i gatuar nga miku i tyre Ismail Ezherliu si dhe supa e pulës e përgatitur nga hafëz Eshrefi, me rastet e vizitave të Akifit, ai i parapëlqente shumë. Ndërsa kur vinte në vizitë pa ngrënë mëngjes në shtëpinë e vet, dhe Akifi gostitej me petë, djathë dhe ullinj, thoshte se “ky zijafet qenka më i mirë”.

Edhe pse Akifi dhe Ihsan efendiu nuk i takonin të njëjtit brez, kishin ngjashmëri të madhe për nga natyra, karakteri dhe mendimi. Për këtë arsye Ihsani i ri, edhe pse Akifi që në moshë më të madhe se vet, i kuptonte vuajtjet e tij dhe nga fytyra e dinte se çfarë është duke menduar apo ndier. Siç transmeton Eshref Edibi nga Ihsan efendiu lidhur me një vizitë të Akif beut tek ai:

“Ustai prapë kishte ardhur në vizitë; na e kishte nderuar medresenë. Me shpejtësi e shtruan sofrën e çajit. E kuptoja se ustai ishte paksa i mërzhitur. Iu drejtova dhe i thashë:

- *Usta, si e vlerëson këtë bejt (dyvargësh) të shejhul-islam Jahja efendiut?*
- *shpirt! Nëse në këtë botë e ke të shkruar të vuash*
- *Miq të ta shkaktojnë atë; s'është e duhur të kesh armiq.*
- *Shumë bukur!*
- *Ustai shprehi interesim për këtë bejt. Kur vinte në medrese më thoshte:*
- *Ihsan efendi, recitoje atë bejt.*
- *Pastaj unë e recitoja dhe ai u emociononte.*⁵

⁴ Eşref Edib (Fergan), *Mehmed Âkif: Hayatı, Eserleri ve Yetmiş Muharririn Yazıları*, Përgatiti: Fahrettin Gün. Stamboll: Beyan Yayınları, 2010, f. 205-206.

⁵ Ibid. f. 140.

Libri “*Hijet*” (*Gölgeler*) i përmban poezitë e Akifit që janë shkruar në Egjipt dhe është botuar në Kajro. Libri të cilin e kishte babai im, i ishte dhuruar nga vetë Akifi dhe e posedonte autografin e tij. Babai e kishte edhe veprën “*Fletët*” (*Safahat*) të Mehmet Akifit, që e kishte siguruar para se të njihet me te. Në faqen e fundit të këtij libri, Akifi, më 1928 e kishte shkruar një strofë dhe e kishte vendosur autografin. Këtë strofë më pas e kishte futë në librin *Hijet*.

Mbetesh pas meje, më kujton me lutje

Kur të shikoja të thosha, o libri im i pafat!

Kush do të thoshte: ti përkulu dhe le të mbesin pas teje

Jeta ime e shkatërruar, të cilën e shkatërrova për ty.

Tre mjekë turq me famë, më 1936 kishin bërë një vizitë në Kajro. Me këtë rast kishte filluar vargu i ngjarjeve që rezultoi me kthimin në Turqi të Mehmet Akifit. Miku im i vjetër Prof. Dr. Ajkut Kazanxhëgil, babai i tij, gjinekologu Prof. Ord. Dr. Tevfik Remzi Kazanxhëgil, Dr. Qazim Ismanil Gyrkan dhe Dr. Ymer Vasfi Ajbar patën ardhë në Kajro në një kongres të kirurgjisë. Gjatë kësaj vizite në Kajro, kishin vizituar edhe Ambasadën turke në Kajro. Nga ambasadori kishin kërkuar të takohen me poetin Mehmet Akif. Ambasadori atyre i kishte thënë se Akifi nuk banon në Kajro por në Hilvan. Por kishte thënë se, mënyra më e lehtë për ta takuar Akifin, është ta gjejnë Ihsan Efendium. Dhe ata i njofton me Ihsan Efendium. Kjo tregon se çfarë miqësie kanë pasur babai im me Akifin. Në fund të krejt kësaj ngjarje, tre mjekë takohen me babain tim dhe ia shprehin dëshirën për tu takuar me Mehmet Akifin. Ja shkruajnë një letër Akifit. Këtë letër e shkruan babai i Ajkut beut. Pas përgjigjes pozitive të Akifit, tre mjekët dhe babai im udhëtojnë për në Hilvan.⁶ Ideja për udhëtimin e Akifit për në Turqi, lind gjatë kësaj vizite. Këtë ngjarje, me detaje, mua ma ka transmetuar Ajkut beu. Siç thoshte ai, koha ishte shumë e nxehtë dhe për këtë arsye, perdet e

⁶ Ali Haydar Aksal, “Koru Avuçlarında Taşıyan Akif’in Hüznü: Gül Devrini Bilseydim Onun Bülbülü Olurdum” *Yedi İklim*, f. 201 (Djetor 2006): 97-98.

shtëpisë në Hilvan ishin të mbyllura. Kur dalin në dritë, mjekët ia vërejnë fytyrën e zverdhur tej mase, dhe mollëzat e faqeve të grupuara. Tevfik Remzi beu kërkon leje nga poeti për ta kontrolluar. Por Akifi me shaka i thotë “vallë ti a nuk je gjinekolog”; por megjithatë nuk e refuzon këtë kërkesë. Tevfik beu, gjatë kontrollit e vëren se gjendja e stomakut dhe gjendja e përgjithshme e trupit nuk është e mirë. Siç transmeton Ajkut beu, Dr. Tevfik Remzi Kazanxhëgili, pasi të kthehet në Turqi, Midhat Xhmeal Kuntajit, një miku të Akifit, i tregon për gjendjen e keqe shëndetësore të Akifit. Më pas Akifi është bindur për tu kthyer në vendlindje për trajtim.

Lidhja e Akifit me qytetin e Jozgatit

Ndërmjet tyre ishte krijuar një afërsi edhe për shkak Jozgatit. Babai i Akifit e kish pasur një mësues nga Jozgati, që quhej Jozgatli Haxhi Mahmud efendi, i cili babait të Akifit ia kishte dhuruar një përkthim të “Kamusit”⁷. Akifi këtë përkthim të Kamusit, që e kishte të trashëguar nga babai vetë, gjithmonë e kishte bartur me vete. Akifi kishte kërkuar informata nga Ihsan efendiu për mësuesin e babait të tij që ishte nga Jozgati. Ihsan efendiu, i kishte shkruar letër miqve të vet për t’i mbledhë informatat e kërkuara, dhe kështu i kishte mbledhë dhe ia kishte paraqitur Akifit. Ihsan efendiu i kishte thënë Eshref Edip beut se: “U befasova se sa u mor me këtë çështje...”.

Akifi interesimin e tij për Jozgatin e kishte zgjeruar edhe në temën e fjalëve të urta. Babai im i kishte thënë Eshref Edip beut:

Ustai ishte kureshtarë për fjalë të urta. Ai dinte përmendësh shumë fjalë të urta. Në çdo tubim gjithmonë i thoshte disa fjalë të urta. Edhe nëna e tij kish ditur shumë fjalë të urta. Ai ishte ushqyer edhe nga fondi i nënës së tij. Më thoshte:

⁷ Vepra e Muhammed Firuzabadî (1329-1414), e titulluar: Kâmûsî'l-Muhît (القاموس المحيط), e përkthyer në gjuhën osmane nga Mutercim Asim Efendi (1755-1820), me titull në përkthim: el-Okyânûsü'l-Basît fi Tercemeti'l-Kâmûsî'l-Muhît [sqarim i përkthyesit].

- *Mësuesi Ihsan! Shumë mirë do të ishte t'i vjelësh fjalët e urta të Jozgatit.*

Pas kësaj fjale edhe mua mu zgjua kureshtja. Mblodha goxha shumë fjalë të urta. Këto ia lexova ustait. Shumë i erdhi mirë. Bile ndërën shumë e pëlqeu: *Duhet të fïtosh miq, armikun ta lind nëna.*⁸

Në bisedat për Jozgatin ndërmjet Akif beut dhe Ihsan efendiut, zihet edhe tema e ushqimeve të njohura të këtij rajoni. Prof. Abdykadir Shener i transmeton fjalët në vijim:

I ndjeri Mehmet Akif beu shpeshherë vinte tek Ihsan efendiu, për të biseduar me te. Një ditë Ihsan efendiu i thotë se “ekziston një gjellë e quajtur *arabashi* (*gjellë arabe*). Edhe pse emërtimi i gjellës lidhet me arabishten, këtu nuk ekziston në gjellë e tillë”. Pasta Akif beu i thotë: “Nëse din, gatuaje ta shijojmë”. Ihsan efendiu e gatuan këtë gjellë dhe u pëlqen të dyve. Më pas Akif beu herë pas herë i kërkonte Ihsan efendiut të gatuj këtë gjellë. Ihsan efendiu i thoshte se “Kjo gjellë gatuhet dimrit. Sepse duhet mot i ftohtë për tu ngrirë brumi”. Aso kohë nuk kishte frigoriferë; prandaj është dashur të pritët dimri.

Nili në netët me dritë të hënës

Nili, burimi i jetës në Egjipt, posaçërisht në netët me dritë të hënës ofron një pamje poetike. Akif beut i pëlqente të ndaj me Ihsan efendiun dhe shokët tjerë në medrese, harenë e shikimit të Nilit në muajt gusht-shtator, kur ai del nga shtrati i vetë. Siç transmeton Eshref Edib beu:

Një rrëfim i Ihsan efendiut:

Ustai na kishte ftuar në buzë të Nilit. Aty ishin edhe Mehmet Eshrefi nga Bajramiçi⁹ dhe Ismail Hakiu (Ezherliu) nga Osmanpazari¹⁰. Kaluam kohë të mira, pimë çaj. Ustai na këndoi ilahi dhe këngë. Ndër-

⁸ Eşref Edib, op. cit., f. 207.

⁹ Një qytezë në Turqi [sqarim i përkthyesit].

¹⁰ Një qytezë në Bullgari; bullgarisht: Omurtag [sqarim i përkthyesit].

sa Eshrefi këndoi Kuran. Aty qëndruam deri vonë. Në një çast një zog këndonte pikëllueshëm. Ustai heshti, e dëgjonte zogun. Tha:

- Shumë pikëllueshëm po këndon.
- Vërtet në kohën e muzgut gjithçka po pikëllohet.

Ishte emocionuar shumë. Ishte duke praruar dielli dhe duke lindë hëna. Rrezet e hënës u reflekttoheshin mbi Nil. Ngjyra e Nilit ndryshonte. Ustai e kishte vënë gishtin në tëmth dhe shikim e kishte të shpërqendruar. I shikonte pamjet e ndryshueshme në horizont dhe rrjedhën e qetë të Nilit.

Nganjëherë i thoshte disa fjalë:

- Ky Nili është shumë i çuditshëm. Edhe ujë sjellë edhe dhe. Më pas prapë heshtë, shpërqendrohet.

Atë ditë nuk mund ta harroj dot. Mbetëm deri vonë në mbrëmje. Tanimë ishim duke u kthyer. Bretkosat kuaknin. Ustai na tha:

- Shkëlqesitë e tyre qenkan akorduar. Kuakin në harmoni.

Duke ecur filloi hëna të zihet. I thash:

- A mos hymë ne ndërmjet dhe i penguam rrezet e diellit?

Ustai qeshi dhe:

- Po të keq që jemi!¹¹

Ismail Ezherliu, njëri prej tre shokëve pjesëmarrës në këtë ndejë mbrëmjeje në këtë stinë, në kujtimet e pabotuara një ngjarje të ngjashme e transmeton si në vijim:

Tre shokë në një gusht të një viti shkuam ta vizitojmë atë. Namazin e ikindisë dhe të akshamit e falim në buzë të Nilit. Deri vonë në mbrëmje qëndruam nën dritën e hënës. Nga gazetatat u patëm informuar se atë natë do të zihet hëna. Hëna filloi të zihet. U ngremë për t'u kthyer në Hilvan. Gjatë rrugës dëgjuam të shtëna me armë dhe tamtame të teneqesë. Me atë rast Akif beu na tregoi se, tradita e të rënit në teneqe dhe e të bërit zhurmë, ishte kultivuar nga koha e Timurlenkut. Kur

¹¹ Eşref Edib, op. cit., f. 207.

Timuri ka qenë në Anadoll, një profet (parashikues i së ardhmes) kish-te paralajmëruar se do të zihet hëna. Pasi ta ketë dëgjuar këtë Timuri e kishte thirrur profetin për t'u takuar. E kishte pyetur profetin se kur do të zihet hëna. Ai i kishte treguar se cilën natë pritet të zihet hëna sipas llogaritjeve të tija. Timuri i zemërohet këtij profeti që i sjell lajme nga e ardhmja dhe ushtarëve të veti i urdhëron që ta mbajnë në burg profetin deri në mbrëmjen kur e parasheh të zihet hëna. Dhe nëse nuk zihet hëna në mbrëmjen e paralajmëruar, urdhëron që profetin t'i prihet koka. Profeti i sigurt nga dija e vetë, hyn në burg pa u brengosur për fatin e vetës. Fillon ta pres momentin në fjalë. Kur vjen dita dhe momenti, hëna fillon të zihet.

Profeti në burg i pyet rojet nëse mbreti Timur e ka pa zënien e hënës. Rojet i thonë se mbreti është i dehur dhe se nuk është në gjendje ta kuptoj nëse hëna është zënë. Profeti fillon të brengoset dhe mendon se çfarë mund të bëjë për ta vënë në dijeni mbretin për zënien e hënës. I shkon mendja se duhet bërë zhurmë të madhe në mënyrë që mbreti të kthjellët dhe ta sheh hënën e zënë. Rojeve të burgut i drejtohet duke i thënë: “A e shihni se hëna është zënë? Hënën e ka zënë djalli. Nëse nuk shtiem me armë në drejtim të tij dhe nëse nuk bëjmë zhurmë të madhe për ta frikësuar djallin, hëna për gjithmonë do të mbetet e zënë dhe kurrë më nuk do ta shohim qiellin e ndriçuar.” Pasi t'i kenë dëgjuar këto fjalë të profetit, ushtarët dhe eprorët e tyre me shpejtësi japin urdhrin që të bëhet zhurmë e madhe dhe të shtihet me armë në drejti të hënës. Populli marrin teneqe në duar dhe i bien për të bërë zhurmë, ndërsa ushtarët fillojnë të shtëna me armë zjarri. Pas zhurmës së madhe të krijuar, Timuri i dehur kthjellët dhe e sheh se hëna është zënë. Pasi ta ketë parë këtë, ushtarëve i urdhëron që ta lirojnë profetin. Dhe kjo traditë ka mbetur prej asaj kohe. Unë e dija se kur të zihet hëna shtihet me armë dhe se bien tamtame. Por nuk e dija arsyen. Këtë e pata mësuar nga Akif beu.¹²

¹² Ezherli, kujtimet e pabotuara.

Ezherliu më tej vazhdon duke thënë:

Mehmet Akif beu kishte bindjes se shkas i besëtytnive si kjo në fenë islame, ishin diktatorët. Në kohën kur shkohet në hënë, ende ka mysliman që shtënë me armë dhe bien tamtame kur zihet hëna, dhe kanë besime të kota. Akif beu asnjë herë nuk ka pasur besime të kota. Ai e shihte të vërtetën dhe pikëllohej për gjendjen e mjerueshme të myslimanëve. Një namaz të xhumasë e patëm falë në xhaminë “Muhammed Bej Ebu-dheheb”. Isha ulur pran tij. Ligjëruesi që një njeri i ditur. Shpjegonte se në çfarë mjerimi kishte rënë bota islame, që lidhej me një ngjarje për të cilën kishte shkruar një gazetë. Ligjërata e tij ishte e prekshme. Akif beu qante. Pikët e lotit si rruaza, ia lagnin jakën. E nxori shaminë për t’i fshirë lotët. Pas faljes së namazit ligjëruesin e kishte përgëzuar për këtë ligjëratë. Ai po ashtu thoshte se, dijetarët myslimanë duhet të arsimoheshin në mënyrë meritore. Thoshte se ata duhet të zotërojnë disa gjuhë tjera pos arabishtes. Të paktën ta dinë anglishten. Ai thoshte se, qoftë në lindje apo perëndim, veprat islame, pas arabishtes, më së shumti janë të shkruara në gjuhën angleze. Dhe dëshironte që çdo mysliman t’i kryej ritet fetare.

Çfarë miqësie

Mehmet Akifi për çdo bajram e vizitonte Ihsan efendiun. Nga Hilvani për në qendër të Kajros udhëtonte me tren. Kur mbërrinte në Kajro së pari e vizitonte princ Halimin, më pas shkonte te “Haxhi Beqiri”, në një dyqan sheqernash në sheshin e Operës, dhe më pas për të hipur në tramvaj drejt qendrës studentore “Ebu-Dheheb”, shkonte në sheshin Atebe. Kështu mbërrinte për t’ia uruar bajramin Ihsan efendiut.

Babai im poezitë e Akifit i dinte përmendësh. Ky fakt mund të kup-tohet edhe nga shënimet që i ka bërë në faqet e veprës “Safahat”. Edhe anekdota në vijim, që e transmeton Eshrep Edip beu nga Ihsan efendi, e dëshmon një gjë të tillë.

Një ditë patëm shkuar në Hilvan, për një vizitë te Ustai. Kur na gostiti me ujë na dha një lajmë të mirë:

- Ka disa kohë që doja ta merrja një qyp. Më në fund e mora. Tanimë ujin po e pimë të ftohtë.

Kur e përmendi qypin, mua më u kujtuan vargjet e ustait

Kur ju lundronit mbi ujë, pasi t'i keni ngritë velat

Kur ne ju shikonim me mall, të hipur mbi qype¹³

- Po, do të ju duhet edhe për ta ftohur ujin, por edhe për të hipur mbi te kur ta kujtoni Stambollin.

I pëlqeu kjo dhe qeshi.¹⁴

Tregimi në vijim i Ali Ulvi beut, reflekton masën dhe thellësinë emocionale të raporteve mes dy miqve.

Mësuesin Ihsan e pyetnim për kujtimet me të ndjerin Akif bej. Na kishte thënë kështu:

“Shumëçka kam mësuar nga i nderi Akif bej. Jam ushqyer nga dija e tij. Mirësjellja, modestia, drejtësia, trimëria... Të gjitha këto të plota i posedonte ai. Edhe sinqeritetin e dashurinë i kishte të pakufishëm dhe të pashoq.

Akif beu e thoshte një fjalë të sinqertë për mua. Unë këtë fjalë të tije, e kujtoj si një kompliment, një adresim ndaj meje dhe një rast falënderimi për Zotin. I ndjeri disa herë më kishte thënë se:

Ihsan efendi! Njeriu, për nga natyra e krijimit është i qytetëruar, prandaj e ndien nevojën për të jetuar në bashkësi me njerëz dhe për të pasur harmoni në këtë bashkëjetesë. Atij më shumë i pëlqen jeta urbane. Për këtë ka nevojë. Unë këtë e kuptova, pasi që erdha në Egjipt... Po mos të kishe qenë ti, çfarë do të bëja i vetëm në këtë mërgatë?

O Ihsan efendi! Ti që për dhjetë vjet mërgatën ma shndërrove në bregdete ngrohta, bëj dua për ty, ashtu siç lutet një baba ose një nënë për të birin e vet...

¹³ Hip mbi qype (küplere binmek), është një idiomë që nënkupton “zemërohem tej mase” [sqarim i përkthyesit].

¹⁴ Eşref Edib, op. cit., f. 209.

Pra unë jam njeri i që kam pasur fatin të marr duatë e Akifit. Mburrem me këtë. E falënderoj Allahun.

Një anekdotë e shkurtër që tregon për qetësinë dhe sigurinë që e ka ndier Akif beu afër këtij miku të ri, është domethënëse:

Akif beu, në një rast kur pas një udhëtimi të gjatë nga Hilvani për në Kajro, kishte vizituar disa vende por duke mos u takuar me as kë, më pas i djersitur kishte shkuar në dhomë të Ihsan efendiut. Kur mbërrin te Ihsan efendiu, i thotë: “Po mos t’ju kisha gjete këtu, do të pikëllohej sa do të qaja në këtë vend”. Me këto fjalë prekëse ai shpreh masën e miqësisë ndërmjet tyre.¹⁵

Edhe fjalët në vijim e të ndjerit Ismail Haki Shengyler, që tregojnë të njëjtën gjendje emocionale, janë interesante: “[Akif beu] Nganjëherë vetja më duket si peshku i dalë nga uji. Nëse në këso momente të vështira e takoj Ihsan efendiu, e ndiej freskinë e arritjes në det.”

Akif beu vinte në medrese së bashku me miqtë e tij që vinin nga Stambolli; në një rast të tillë kishte ardhur i shoqëruar me Nejzen¹⁶ Tevfik-un. Ismail Ezherliu këtë rast e transmeton si në vijim:

Akifi një ditë e kishte sjellë Nejzen Tevfik beun në medrese. Pasi pimë çaj, e lutëm që të na performoj me fyellin e quajtur nej. Nejzeni u përgjigj duke thënë “Akif bej, nuk mund të performoj aty ku nuk ka jehonë”. Por ne e patëm dëgjuar performancën e tij në ritualin “sema¹⁷”, ritual që realizohet për çdo javë në mevlevihane^{18, 19}.

Kur Ismail Ezherliu thotë se “e patëm dëgjuar”, nënkupton se i pranishëm ka qenë edhe babi im.

¹⁵ Eşref Edib, op. cit., f. 212.

¹⁶ Nejzen: performues i një lloji fyelli nga kallami, i quajtur “nej” [sqarim i përkthyesit].

¹⁷ Ritual vallëzimi i dervishëve të rendit mevlevi, i cili realizohet në shoqërim të ilahive të kënduara dhe me korepeticion të veglave muzikore nej, kudum dhe rebap [sqarim i përkthyesit].

¹⁸ Teqe e rendit Mevlevi [sqarim i përkthyesit].

¹⁹ Ezherli, kujtimet e pabotuara.

Babai im i cili me raste të ndryshme e kishte vizituar Akifin në Hilvan, me rastin enjë vizite në ramazan shprehët kështu:

Disa mbrëmje të ramazanit ne u bënim xhemat i Ustait. Këndonte (Kuranin) pa gabime. Ne i thoshim “Usta, ju vërtetë qenkeni bërë hafëz²⁰ i hekurt”. Ai u përgjigjtë duke thënë “Po, për këtë i shkrova edhe mësuesit tim. I thash se, unë e përforcova këndimin e Kuranit me ndihmën tuaj. Tani i falë teravitë²¹ me hatme²². Më dërgo myslimanë të qëndrueshëm.”²³

Ismail Ezherliu i cili këtë temë e përshkruan me stilin e tij “me ngjyra”, thotë kështu:

Mehmet Akif beu ishte hafëz. Në moshën e fëmijërisë hafëzllakun e kishte të vërtetuar. Më vonë nga Hafëz Arapi, imami i xhamisë “Fatih” (në Stamboll), kishte mësuar edhe mekamin (e këndimit të Kuranit). Nuk e dija se ishte hafëz. Kur kishte ardhur në Egjipt, hafëzllaku iu kishte dobësuar. Kurdo që kishte gjete kohë ishte angazhuar për ta forcuar hafëzllakun e tij. Por nuk kishte arritur një gjë të tillë, pasi këtë donte ta bënte me shpejtësi. Pastaj kishte insistuar që ta bëjë një gjë të tillë. Për disa muaj kishte bërë ushtrime për ta përforcuar hafëzllakun dhe kishte arritur ta përforcoj në nivelin e moshës së re. Në atë kohë ish afruar edhe ramazani. Prandaj i kish shkuar mendja që teravitë t’i falë me hatme. Natyrisht një gjë e tillë mund të bëhej në shtëpi, jo në xhami. Prania e xhematit pas imamit, do të ishte një inkurajim për te, për t’i falë teravitë me hatme. Në atë kohë Tahiri, i biri i tij, ishte fëmijë. Kur kishte vendosur që teravitë t’i falë me hatme në shtëpi, nuk ka mundur të gjej xhematë. Prandaj ka bërë një marrëveshje me Tahirin, po që se i bëhet xhematë, për bajram Tahirin t’ia blejë një komplet

²⁰ Ai i cili e mëson dhe e këndon Kuranin përmendësh [sqarim i përkthyesit].

²¹ Namaz që falët gjatë muajit të ramazanit, pas vaktit të jacisë [sqarim i përkthyesit].

²² Këndimi përmendësh ose duke lexuar i Kuranit, prej fillimit deri në fund. “Falja me hatme” nënkupton falja e teravive duke i kënduar përmendësh pjesët Kuranore sipas radhitjes së hatmes, duke e mbaruar çdo natë nga një pjesë që quhet “xhuz” [sqarim i përkthyesit].

²³ Eşref Edib, op. cit., f. 209-210.

me setër dhe pantallona dhe një orë dore. Tahiri e ka pranuar këtë ofertë. Kur vjen ramazani dhe ia fillojnë t'i falin teravitë, kah mesi i ramazanit vjen në medrese. Pasi na e patë tregoi rastin e sipërm, na ftoi një mbrëmje të shkojmë në iftar te ai dhe të falim teravitë me hatme; duke na thënë “të bindem edhe vetë unë, se po i fali teravitë me hatme”. Na tha se “Thairi nganjëherë po më zhduket duke i falur teravitë. Po shkon deri në kuzhinë për të ngrënë sytliac apo diçka tjetër dhe po kthehet. Kur po e kam dikë prapa, po ndihem ndryshe”. Në ditën që u morëm vesh shkuam në Hilvan. Ishim tre shokë. Pas iftarit u bëmë gati për teravi. Hafëz Eshrefi, shoku ynë, u bë myezin. Atë mbrëmje Tahiri që i liruar nga teravia. Akif beu në anën e djathtë të sexhades i kishte vendosur dhjetë kokrra misri. Pas çdo rehati nga një kokërr misri e zhvendoste në një tjetër vend. Në këtë mënyrë iu kujtoheshin rekatet dhe faqet e Kuranit.

Edhe hafëz Eshrefi e kishte hafëzllakun e fortë. Akif beu atë natë i fali teravitë duke e kënduar një xhuz pa gabime. Biseduam deri orët e vonë të natës dhe më pas u kthyem në Kajro. Kur shkuam për vizitë në bajramin pas ramazanit, e shoqja e Akifit të gjithëve na i dhuroi nga një kapuç. Zoti e mëshiroftë. Ai na tregoi se për këtë çështje i kishte shkruar edhe imamin të xhamisë “Fatih” në Stamboll. I kishte thënë se nëse ia dërgojnë disa njerëz të qëndrueshëm edhe vitin e ardhshëm do ti falte teravitë me xhematë.²⁴

Akifi kur shkonte në vizitë te Ihsan efendiu në medrese, ndiente kënaqësi për gostinë që ia bënin dhe kënaqej që të bisedonte me medresantët në sofrën e tyre modeste. Në shenjë falënderimi Akifi i ftonte medresantët në shtëpinë e tij dhe i gostiste ata me ushqime të shijshme që i gatuantë e shoqja e tij. Lidhur me këtë Ezherliu transmeton si në vijim:

“Akif beu na ftonte edhe neve. E shoqja e tij gatuantë ushqime shumë të shijshme. Gatuantë supë, bamje me pulë apo dollma të pata-

²⁴ Ezherli, kujtimet e pabotuara.

teve. Por më e shijshmja ishte ëmbëlsia e mollës. Me shprehjen e Akif beut ishin ushqime pikante. Një ditë vere i kishte ardhur hafëz Ali efendiu, një mik i tij nga Izmiri. Më vete e kishte pruar një kuti me vaj ulliri. Pasi ishte kthyer mysafiri i tij, ai na vizitoi dhe na tha: Djema, para disa dite erdhi hafëz Ali efendiu, nga Izmiri. Faleminderit prej tij, na e kish sjellë një kuti vaj ulliri. Ejani një ditë të hamë sarma me fleta rrushi. Ne shkuam ditën kur ai na ftoi. Aso kohë në Egjipt ndodhej edhe Shejhulislam Sabri efendiu. Hëngrëm ushqim. Ëmbëlsira e mollës me kajmak qe e përkryer. Pasi që e hëngrëm nga një pjesë të gjithë, unë tash se nga pjesa e mbetur unë mund të ha ende. Shumë iu bë qejfi. Derisa e haja porcionin e dytë, e lëshoi një shikim impresionues. Më pas u shpreh: “Të bëftë mirë hoxhë Ismaili. Kur isha i ri edhe unë haja kaq shijshëm.”²⁵

Prapë transmeton i ndjeri Ezherliu:

Disa ditë para një kurban bajrami kishte ardhur në medrese. Me të ardhur na i dha myzhdënë. Na tha: Djema, Abbas Halim pasha dje e kishte dërguar një lajmëtar dhe kish thënë se “nëse Akif beu ka vend për ta vendosur, në bajram do t’ia dërgoj një kafshë për kurban”. Lajmëtarit ia tregova oborrin e rrethuar me mure dhe i thash me shaka: “Kemi vend të mjaftueshëm jo për një dele, por për një tufë të tërë. I gjithë ky oborr është i yni”. Tash erdhi kurhani. E shoqja është pa qejf. Nuk ka fuqi që të gatuaj. Për këtë arsye, pas faljes së namazit të bajramit ejani tek unë. Ne vetë do ta therim kurbanin dhe do të përgatisim për vetën diçka për të ngrënë.

Pas namazit të tretë shkuam në Hilvan. Para se të shkonim ne, Akif beu e kishte therë kurbanin dhe ia kishte zhveshë lëkurën. Neve na kishte mbetur vetëm përgatitja e ushqimit për të ngrënë. Nga kurhani patën ndarë edhe disa pjesë për fqinjët. Ndërsa Tahiri njëren kofshë të kurbanit ia kishte dërguar disa të afërmeve të tyre në Kajro. Kurse Emini tjetrën kofshë ia kishte një të afërmi tjetër. Nga pjesa e mbetur e

²⁵ Ezherli, kujtimet e pabotuara.

mishit bëmë jahni dhe kaurma dhe e hamë në shtëpi. Pastaj bëmë dua për pashain dhe Akif beun.²⁶

Mos vallë po zbehet kjo miqësi

Miqësia mbi dhjetëvjeçare, në një çast dukej sikur do të zbehet. Ngjanë diçka të cilën e transmeton Ismail Ezherliu, i cili ishte shoku i dhomës i Ihsan efendiut por njëkohësisht edhe studenti dhe miku i tij. Ai shprehet si në vijim:

Një ditë Akif beu, autori i Marshit të pavarësisë, kishte erdhur në vizitë tek Ihsan efendiut. Bisedonin në dhomën e Insan Efendiut, në qendrën studentore “Ebu Dheheb”. Gjatë bisedës çelet tema e devotshmërisë. Akif beu, nën ndikimin e halleve të mërgimit Ihsan efendiut i thotë:

- A pajtohesh se ne jemi njerëz të cilëve devotshmëria i është imponuar nga kushtet?

Pas kësaj fjale Ihsan efendiut për një kohë nuk kishte folur me te; edhe pse ai ishte ndër njerëzit më të dashur dhe të respektuar për Ihsan efendiun. Për Ihsan efendiun kjo çështje ishte temë për të cilën nuk e toleronte shakanë; sepse vetë ishte përcaktuar për një jetë të tillë. Askush nuk e kishte shtyrë atë që të sakrifikoje nga vetja. Devotshmëria nuk ishte një shkallë që arrihet me imponimin e dikujt. Si ishte e mundur që Akif beu të bënte një shaka të tillë?²⁷

Pasi të kaloj hidhërimi i shkaktuar nga kjo ndjeshmëri e Ihsan efendiut, miqësia, respekti dhe besnikëria e ndërsjellë, përkundër sfidave dhe presioneve të shumta, vazhdon deri në fund të jetës së tyre. Akifi, gjatë ballafaqimit me sprovën e madhe në vitet e fundit të jetës së tij, sekretet dhe amanetin e tij që ishte *këmishë nga zjarri*, mund t’ia besonte vetëm Ihsan efendiut.

²⁶ Ezherli, kujtimet e pabotuara.

²⁷ Ezherli, kujtimet e pabotuara.

Momentin e ndarjes së kësaj miqësie të pashoq dhe shoqërimit shpirtëror, Ihsan efendiu ia kishte treguar Eshref Edip beut. Ai e transmeton kështu:

Kur u informuam për sëmundjen e tij, u bëmë sikur të na kishte qëlluar rrufeja. Ishte shumë i fuqishëm. Kurrë nuk mendonim se do të sëmurej në mushkëri. Ai brengosej për gjithçka, por nuk e shprehte brengën e tij. Kur erdhi në vizitë për herë të fundit para se të kthehej në Stamboll, ishte shumë i zbehur. Ishte shtrirë mbi krevat si një xhenaze e gjallë. Pushoi gjatë. Atë ditë u ndamë me lot. Ishte e qartë se nuk do ta takonim më.

Shumë vite i kaluam së bashku. Iu bëmë shoq edhe i gëzimeve edhe i pikëllimeve të tij. Sa herë që gëzohej ose pikëllonte, me vrap vinte tek ne. Atë e gëzonte shumë singëriteti dhe respekti që e gëzonte në dhomën tonë modeste. Pasi që i shpërndahej pikëllimi rrezatonte hare në dhomën tonë. Kështu na kaluan vitet e tra në mërgim. Prania e tij, muhabeti i tij na i mbushte zemrat, saqë e ndiejmë sikur të ishte gjallë ende. Nuk mund të pajtohemi dot me vdekjen e tij. Ishte njeri shumë i madh. Ishte njeri i përkryer. Ai ishte fati më i madh për një njeri që dëshiron të pasurohet me dije. Allahu e mëshiroftë!²⁸

Përse Ihsan efendiu e donte Akif beun?

Uniteti i lartpërmendur që bazën e kishte në botëkuptimin miqësisë emocionale dhe edukatë, mbështetej edhe në ngjashmërinë karakterit të tyre si dhe në përafrimin e mendimeve gjatë kohës së kaluar me respekt të ndërsjellët ndërmjet tyre. Ali Ulvi beu nga babai im transmeton kujtimin në vijim.

Ihsan efendiu, krahas intelektualëve që me gabimet e tyre i shkaktoni dëme popullit, me mirësi i kujtonte sjelljet dhe idetë e matura dhe të qëlluara të Akif beut, duke thënë:

²⁸ Eşref Edib, *Mehmed Âkif...*, f. 213.

Pëse e duam Akifin? E duam se ai së bashku me popullin i ndien ndjenjat e njëjta. Ai është bërë interpret i shpirtit tonë. Ai i ka zbuluar hallet dhe brengat tona; është pikëlluar me to, na ka ngushëlluar dhe ka gjete zgjidhje për to... Ai as nuk i është dorëzuar në tërësi botës perëndimore, siç bënin të tjerët, as nuk i ka nënçmuar perëndimorët duke i quajtur *jobesimtarë* dhe se nuk i ka konsideruar se *nuk kuptojnë asgjë*.

Ihsan efendiu i di përmendësh poezitë e Akif beut, dhe se kur bie fjala i recitonte dhe i komentonte ato. Gjatë miqësisë dhjetëvjeçare kishte pasur mundësinë që ta njihnte mirë atë.

Ali Ulvi beu thekson se ndër turqit që jetonin në Kajro gjatë kohës kur kishte jetuar edhe Akif beu, Ihsan efendiu ishte ai që më së miri e njihnte atë. Ai këtë e shpreh saktësisht kështu:

Ihsan efendiu Akif beun ia kishte shpjeguar mirë Mustafa Sabri efendiut dhe Ibrahim beut, dhe e kishte vlerësuar mëshirshëm. Akif beu i kishte thënë se “Kam plogështi, nuk kam më fuqi. Për pesëmbëdhjetë vite bëra përpjekje që vendi ynë të mos bëhet kështu... Por tani nuk kam çfarë të bëjë”.

Ndërsa Ibrahim Sabri beu, një kritikues i Akifit, mendoj se nuk ka qenë i informuar plotësisht se sa Akifi i ka kontribuar islamizmit në Turqi dhe se sa e kanë dashur myslimanët atë.

Ligjërata për Safahatin²⁹ në Medresenë “Sulltan Mamud”

Në kapitujt relevant të librit në pikëpamje të ndryshme trajtuam veprimtarinë arsimore e kulturore të Ihsan efendiut, i cili më 1934 filloi të ligjëroj në Medresenë “Sulltan Mahmud”. Në këtë shtjellim patëm treguar se si i ka mbajtur leksionet për letërsinë osmane dhe si i ka recituar poezitë e Zija pashait. Me këtë rast Ali Jakup beu i kishte kër-

²⁹ Shënim i përkthyesit: Njëra prej veprave të Mehmet Akif Ersojit, e botuar më 1911 me alfabet osman-arab. Më vonë, më 1943, të gjitha poezitë e Mehmet Akif Ersojit janë botuar me alfabet latin, në një vëllim të vetëm, me titullin Safahat. Në gjuhën shqipe është përkthyer me titullin “Fletët”.

kuar që të recitonin poezi nga Safahati. Këtë kërkesë të Ali Jakup beut nuk ia kishte kthyer prapa, dhe i ka lejuar të recitojnë poezi nga Safahati. Ato ditë Ali Ulvi beu i përshkruan në kujtimet e tija si në vijim:

Ali Jakup beu një ditë Ihsan beut ia bëri një lutje. I tha, “nëse vij gjysmë ore para mësimit, a më lejoni që të lexoj Safahatin? Nën mbi-këqyrjen tuaj dua ta lexoj Safahatin prej fillimit deri në fund. Dua të më tregoni nëse jam duke e lexuar mirë dhe nëse e kuptoj gabim ndo-një pjesë.”

Për kundër faktit se Ali Jakup beu ishte shqiptar, osmanishten e le-xonte shumë mirë dhe pa gabime. Edhe shkrimin e kishte të bukur.

Një ditë kur shkova në mësim, ata ishin duke lexuar Safahatin. Kur ne erdhëm e mbyllën librin. Ali Jakup beu nganjëherë i kishte disa pyetje të brishta. Pa u përqendruar mirë i shtronte pyetjet. Edhe atë ditë iu drejtua Ihsan efendiut:

Pasi ju po e dini mirë Safahatin, po ashtu Akif beun e kuptoni më mirë se ne dhe e doni atë... Së këndejmi po kërkohet që ta thjeshtësoj-më Safahatin. Vallë nuk ishte mirë që një gjë të tillë ta bënit ju?

Ihsan efendi u përgjigj me buzëqeshje:

I nderuar, në atë rast do të mbetët vetëm uji i pastër. Nuk do të mbetët asnjë grimcë në te. Uji i pastër nuk të ushqen. Në supë duhet të kesh copëza. Nëse ky popull do të vijë në gjendje saqë mos ta kuptoj Safahatin, le të zhduket dhe Zoti ta krijoj një popull tjetër. Juve dua t’ju the një gjë. Kohëve të fundit po dëgjoj se nuk duhet të mbani fjalorë kur të lexoni poezi. Poezinë dashka kuptuar pa e shikuar fjalorin. Si është e mundur? Sigurisht se në çdo poezi do të hasni fjalë që kupti-min duhet t’ia mësoni nga fjalori. Një poet me përvojë, i ditur, me nd-jenja, është menduar thellësisht që ndjenjat, emocionet, entuaziazmin e tij më të çmueshëm ta bartë në letër. Për këtë sigurisht që do të përdorë fjalë që nuk përdorën në biseda të zakonshme, e që shprehin kuptime sublime dhe figuracione të larta. Kjo vlen për të gjitha gjuhët. Si mund t’i lexosh më shumë se dhjetëmijë vargje të Safahatit pa e shikuar fjalorin. Poezinë a e ke profesion? Sa je i familjarizuar me fjalorin? Sa

vjeçar duhet të jesh për të lexuar poezi? Pesëmbëdhjetë, njëzet apo pesëdhjetë? Njeriu vallë lindë me kompetencë gjuhësore të nivelit letrar, në mënyrë që në çfarëdo moshe të kuptoj cilindo tekst letrar? Këto janë ide të çoroditura.

- Njeriu (Akifi) të gjithë jetën ia ka kushtuar, ku ia ka filluar me *Xhaminë "Fatih"*, për ta mbaruar me *"Artistin"*. Në poezinë e tij e ke njëshmërinë e Zotit, e ke klithmën, e ke xhaminë, kafenenë, të sëmurin e tjerë e tjera...

- I ka shkruar të gjitha përjetimet e fazat e katërmbëdhjetë shekujve të islamit, gjashtë shekujve të Perandorisë osmane, mijëvjeçarit e historisë turko-islame...

- Ka përshkrime, ka klithmë, mendime! E ti do që t'i lexosh dhe t'i kuptosh të gjitha këto, pa e konsultuar fjalorin. Kini pak mëshirë!

Ali Jakup beu tashmë ishte penduar për pyetjen e bërë dhe kishte heqë dorë nga pyetja e tij. Edhe pse tentonte të tërhiqet nga pyetje duke thënë:

- U tërhoqa nga pyetja!

Por Ihsan efendiu nuk e kishte ndërmend ta mbyllte këtë temë të rëndësishme. Vazhdoi duke i thënë:

- O bir! kjo çështje e thjeshtësimi është një mënyrë, një arsyetim për t'i lënë popullin injorant. Njerëzit janë përtacë. Sa më shumë lehtësira t'i ofrosh, mësohen me komoditetin. I shmangën veprave që kërkojnë mundë për t'i kuptuar. Në këtë mënyrë pas disa brezave i tërë populli detyrohet në injorancë. Pas kësaj njerëzit e ditur, të vyeshëm bëhen të padëshirueshëm. Pikërisht kjo do të thotë katastrofë.³⁰

Përktheu:

İsa Sülçevsi

³⁰ M. Ertuğrul Düzdağ, *Üstat Ali Ulvi Kurucu: Hatıralar*, c. 1, MED Kitap, f. 380-382.